VENDIM
Nr. 363, datë 16.6.2021

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, TË PRONËS NR. 442, ME EMËRTIM "ISH-BATALION I GATSHËM", ME VENDNDODHJE NË METEOR, SHTIQEN, KUKËS, DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, TË DISA OBJEKTEVE DHE TË NJË SIPËRFAQEJE, TRUALL FUNKSIONAL, PJESË E PRONËS NR. 436, ME EMËRTIM "NDËRTESË SINOPTIKE", ME VENDNDODHJE NË KUKËS, KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TE MINISTRIA E MBROJTJES, TË NJË SIPËRFAQEJE PREJ 1 181 m^2, DY AMBIENTE ZYRASH TE GODINA E MBROJTJES NDAJ ZJARRIT, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 515, DATË 18.7.2003 DHE NR. 343, DATË 7.6.2006

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të pronës nr. 442, me emërtim "ish-Batalion i Gatshëm", me vendndodhje në Meteor, Shtiqen, Kukës, sipas formularit dhe planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi, për t'i përdorur në funksion të zbatimit të kontratës koncesionare/PPP "Për rehabilitimin, operimin, transferimin e aeroportit të Kukësit".
2. Dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, me afat 30 (tridhjetë) vjet, të objekteve së bashku me truall funksional, në total me sipërfaqe prej 2 302 (dymijë e treqind e dy) m^2, dhe objektin nr. 1, me sipërfaqe 98.3 m^2, pjesë e pronës nr. 436, me emërtim "Ndërtesë sinoptike", me vendndodhje në Kukës, sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi, për t'i përdorur në funksion të zbatimit të kontratës koncesionare/PPP "Për rehabilitimin, operimin, transferimin e aeroportit të Kukësit".
3. Kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Autoriteti i Aviacionit Civil) te Ministria e Mbrojtjes, të një sipërfaqeje prej 1 181 (një mijë e njëqind e tetëdhjetë e një) m^2, 2 (dy) ambiente zyrash te godina e Mbrojtjes ndaj Zjarrit, për ndërtimin e ndërtesës sinoptike dhe kopshtit meteorologjik për nevojat e Komandës së Forcës Ajrore.
4. Ndryshimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 515, datë 18.7.2003, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar, dhe nr. 343, datë 7.6.2006, "Për pronësinë dhe administrimin e aeroportit të Kukësit", sipas planrilevimeve dhe skicës që i bashkëlidhen këtij vendimi e që janë pjesë përbërëse e tij, për t'i përdorur në funksion të zbatimit të kontratës koncesionare/PPP "Për rehabilitimin, operimin, transferimin e aeroportit të Kukësit" dhe për ndërtimin e ndërtesës sinoptike dhe kopshtit meteorologjik për nevojat e Komandës së Forcës Ajrore.
5. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i transferohen në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar, të hiqet prona nr. 442, me emërtim "ish-Batalion i Gatshëm", me vendndodhje në Meteor, Shtiqen, Kukës, sipas planrilevimit bashkëlidhur, dhe të shtohet prona me sipërfaqe 1 181 (një mijë e njëqind e tetëdhjetë e një) m^2, me vendndodhje në Meteor,

Shtiqen, Kukës, sipas skicës dhe planrilevimit bashkëlidhur, si dhe 2 (dy) ambiente zyrash te godina e Mbrojtjes ndaj Zjarrit në këtë pronë, të cilat do të përdoren për ndërtimin e ndërtesës sinoptike dhe kopshtit meteorologjik.

6. Në pronën e paluajtshme shtetërore, sipas vendimit nr. 343, datë 7.6.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për pronësinë dhe administrimin e aeroportit të Kukësit", të hiqet sipërfaqja 1 181 (një mijë e njëqind e tetëdhjetë e një) m^2 me vendndodhje në Meteor, Shtiqen, Kukës, sipas skicës dhe planrilevimit bashkëlidhur, si dhe 2 (dy) ambiente zyrash te godina e Mbrojtjes ndaj Zjarrit, dhe të shtohet prona nr. 442, me emërtim "ish-Batalion i Gatshëm", me vendndodhje në Meteor, Shtiqen, Kukës, sipas planrilevimit bashkëlidhur.

7. Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e përdorimit të pronave, të përcaktuar në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij vendimi, t'i tjetërsojnë ose t'ua japin ato në përdorim të tretëve.

8. Ministria e Mbrojtjes, e përfaqësuar nga Komanda e Forcës Ajrore dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të lidhin aktmarrëveshje ndërmjet palëve për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, për një periudhë 30-vjeçare, të sipërfaqes prej 2 302 (dymijë e treqind e dy) m^2 dhe objektin nr. 1, me sipërfaqe 98.3 (nëntëdhjetë e tetë pikë tre) m^2, të pronës me nr. 436, sipas planrilevimit, duke përcaktuar kushtet e detyrimet e ndërsjella ndërmjet palëve për sigurinë dhe ruajtjen e pronës, spostimin e rrjeteve inxhinierike që prek gjurma e sipërfaqes së pronës, sipas parametrave e kushteve teknike.

9. Ministria e Mbrojtjes, e përfaqësuar nga Komanda e Forcës Ajrore, dhe Ministria e Infrastrukturës, para dorëzimit të sipërfaqeve të pronave sipas këtij vendimi, të lidhin marrëveshje me shoqërinë koncesionare të aeroportit të Kukësit, me detyrimin e këtij të fundit për ndërtimin e ndërtesës sinoptike dhe kopshtit meteorologjik, vendosjen e një kontejneri për magazinimin e materialeve dhe furnizimin me energji elektrike, ujë të pijshëm dhe internet për nevojat e Komandës së Forcës Ajrore.

10. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDOSJA E AMBIENTIT TE ZYRAVE TEK
GODINA E MNZ



Shpjegues:

Zyre per Stacionin Meteorologjik te Ushtrise

Zyre per Stacionin Meteorologjik te Ushtrise

DUKES INTERNATIONAL AIRPORT Sh.p.k. NUIS: L97531201R

E
TEOROLOGJIK
tave
orage
nt
UNAL AIRPORT
1201R
. Suleiman Shemsiu
RUGA
ETOJA
ERTIKA
TALLUSHI
LLOZHI

3

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE
Prona nr.442 "Ish Batalioni i Gatshëm", Meteor, Shtiqën, Kukës
(Për Transferim nga MM te MIE)

PRONARI SHTET MM (Komanda Mbështetëse) DATË 14 /06/2021 QËLLIMI: Transferim nga MM tek MIE

VENDNDODHJA
Bashkia KUKËS DVASHK KUKËS Nr.Pasurisë 774/2 Z.K 3425 Indeksi i Hartës K-34-65-(238-A)

TE DHËNAT E PASURISË
Lloi i pasurisë _____ Sip e pasurisë **12 821.2m²** Sip e gjurmës së ndërtimit Ojektet me nr.1,2,3,4,5,6,7,8 Nr. kateve

Nord =4656255.15
East = 534183.14

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)

Nord =4656255.15
East = 534623.05



Nord = 4655904.08
East = 534183.14

SH 1: 2500
0 25 50
METRA

Nord = 4655904.08
East = 534623.05

NR	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT
1	Veri			4050, 5697	K51726024H
2	Lindje			774/3	
3	Jug			774/3	
4	Perëndim			5697	

REALIZOI PËR IGJIU
Specialist Ramiz Haxhiu
KONFIRMOI PËR IGJIU
DREJTORI Ark. Enea SINOIMERI

REALIZOI PËR ASHK
Specialisti _____
DVASHK _____
Nënshkrimi _____
KONFIRMOI
Përgjegjësi/Drejtori _____
Nënshkrimi/ Vula _____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE Z-Zyrë; O-Ortofoto;
PËRCAKTIMI I KUFIRIT: Sipas gjendjes faktike në terren.
Shënime : Ky planrilevim u hartua në zbatim të shkresës së SHSHP të FA nr.3634/1, datë 10.06.2021 bazuar në dokumentacionin hartografik marrë në arkivin e IGJIU, dhe projektit të zgjerimit të aeroportit të Kukësit,i/lidhur shkresës së KFA-së nr.1091, datë 29.03.2021
PRONARI: SHTET MM (Komanda Mbështetëse)
MIRATOHET
ZV/KOMANDANT I KOMANDËS MBËSHTETËSE
Kolonel Përparim GEGA

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE
Prona nr.436 "Ndërtesa e Sinoptikës", Kukës (Sip. dhe objekti për dhënie në përdorim MIE-s)

PRONARI SHTET MM (Forca Ajrore) DATË 14 /06/2021 QËLLIMI: Dhënie në përdorim nga MM tek MIE

VENDNDODHJA
Bashkia KUKËS DV ASHK KUKËS Nr.Pasurisë 774/3 Z.K 3425 Indeksi i Hartës K-34-65-(238-A)

TE DHËNAT E PASURISË

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI: MIE, AAC DATË 16/06/2021 QËLLIMI: Kalim pergjegjësi administrimi

VENDNDODHJA
Bashkia: Kukës DVASHK/ZVASHK: Kukës Nr.Pasurisë:771/41; 771/42 Z.K:3425 Indeksi i Hartës:K-34-65-(238-A)

TE DHËNAT E PASURISË
Lloi i pasurisë_____
Sip e pasurisë 771/41= 2788.8 m²
Sip e pasurisë 771/42= 2878.7 m²
Sip e gjurmës së ndërtimit nuk ka
Nr. kateve____
Nr. pemeve____

Nord = 4655581.074
East = 534275.729

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)

Nord = 4655581.074
East = 534715.639



SHPJEGUESE:
PËR NDARJE PASURIE
Parcela nr.771/41 me sip.2788.8m² vijon: { Parcela 1=2208.8 m² / Parcela 2= 580.0 m²
Parcela nr.771/42 me sip.2878.7m² vijon: Parcela 1=2277.7 m² / Parcela 2= 601.0 m²
PËR BASHKIM PASURIE
Parcela 2 e pas. nr.771/41 = 580 m²
Parcela 2e pas. nr.771/42= 601 m² vijon:
{ Parcela me sip.1181m², që do ti kalojë në përgjegjësi administrimi MM, Forcës Ajrore
Kufiri i sip. që do ti kalojë në përgjegjësi administrimi MM, Forcës Ajrore
Sipërfaqja = 1181m²

Nord = 4655230.004
East = 534275.729

SH 1: 2500

Nord = 4655230.004
East = 534715.639

NR ORIENTIMI	PËRDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT
1 Veri				
2 Lindje				
3 Jug				
4 Perëndim				

REALIZOI :
Specialist : ing. Sokol HASIMLLARI
Nënshkrimi_____

REALIZOI PËR ASHK
Specialisti_____
DVASHK_____
Nënshkrimi_____
KONFIRMOI
Përgjegjësi/Drejtori_____
Nënshkrimi/ Vula_____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE_____
Kodet për teknologjinë e matjeve: T; Z; O; D
PËRCAKTIMI I KUFIRIT_____
Kodet për Përcaktimin e kufirit: P; K; HK

SHËNIME TË VEÇANTA:
Sipërfaqja që kërkohet të kalojë në pergjegjësi adminiustrimi nga MIE, AAC tek MM, Forca Ajrore u përcaktua në vend në bashkpunim me specialistët e Forcës Ajrore, me qëllim ndërtimin e Stacionit Metrologjik Ushtarak

PRONARI/BASHKPRONARËT-DEKLARIM NË LIDHJE ME KUFITARËT
MIRATOHET
DREJTORI I AUTORITETIT AVIACIONIT CIVIL
Edlira KRAJA
Vule-Firme